6.1	Nga puna e pajisjeve si psh. motora, impiante ventilimi, thërmues guri?	Po.	Zhurmat do shkarkohen gjate kohes se ndertimit nga mjetet levizese.	Do merren masat per zvogelimin deri ne eliminim te tyre.
6.2	Nga procese industriale ose të ngjashme?	Jo.	Ska procese industriale.	Jo.
6.3	Nga ndërtime apo prishje?	Po.	Ka zhurma gjate fazes se ndertimit.	Te paperfillshme.
6.4	Nga plasje ose futje pilotash?	Jo.	Ska perdorime te tilla.	Jo pasi ska perdorim te lendeve plasese.
6.5	Nga trafiku gjatë ndërtimit ose shfrytëzimit ?	Po.	Ka zhurma nga trafiku gjate ndertimit.	Nuk ndikojne ne mjedis keto zhurma gjate perdorimit.
6.6	Nga sistemet e ndriçimit ose ftohjes?	Po.	Sistemet e ftohjes se transformatoreve.	Te paperfillshme ne zhurme.
6.7	Nga burimet e rrezatimit elektromagnetik (merr në konsideratë efektet mbi pajisjet e ndjeshme në afërsi ashtu si dhe për njerëzit)?	Po.	Ka krijim te fushes elektromagnetike si rezultat i fushes magnetike te tensionit.	Ska ndikim me mjedisin ndersa me popullaten eshte ne distance te konsiderueshme.
6.8	Nga çdo burim tjetër?	Jo.	Ska burime te tjera.	Jo.
7. A do të çojë projekti në rreziqe të ndotjes së tokës ose ujit nga shkarkimet e ndotësve në tokë ose në kanalizimet e ujërave të bardha dhe të zeza, ujërat sipërfaqësorë, ujërat nëntokësorë, ujërat bregdetare ose në det?				
7.1	Nga përpunimi, depozitimi, përdorimi ose shkarkimi i materialeve të rrezikshme ose toksike?	Jo.	Ska perdorime te tilla.	Jo.
7.2	Nga shkarkimet e ujërave të zeza ose rrjedhjeve të tjera (të trajtuara ose të patrajtuara) në ujë ose në tokë?	Jo.	Sdo kete shkaktime te tilla rreziku nga ujerat e zeza.	Jo, ska rrezik nga keto te fundit.
7.3	Depozitimi i ndotësve të shkarkuar në ajër, në ujë ose në tokë?	Jo.	Depoziton sasi (N) dhe rekuperon sasi te madhe (O2), (CO2)	Depozitim i azotit dhe rekuperim i O2, CO2, SO2

**RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT
ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"**

7.4	Nga çdo burim tjetër?	Jo.	Ska burime te tjera.	Ska burime te tjera.
7.5	A ka rrezik të ndonjë akumulimi afatgjatë të ndotësve në mjedis nga këto burime?	Po.	Ka rrezik afatgjate te akumulimit te azotit per arsye se ka basen te hapur.	Ka ndikim ne mjedis pasi baseni eshte i hapur.
8. Ekziston rreziku i aksidenteve gjatë ndërtimit apo shfrytëzimit të projektit që mund të ndikojë në shëndetin e njerëzve apo mjedis?				
8.1	Nga shpërthime, zjarre, nxjerrje etj. nga depozitimi, përdorimi ose prodhimi i substancave të rrezikshme ose toksike?	Jo.	Ska rrezik zjarri e aq me teper lende djegese apo toksike.	Jo ska ndikime ne mjedis nga keto lende.
8.2	Nga ngjarje që kapërcejnë kufijtë e mbrojtjes normale të mjedisit, psh dëmtimi i sistemit të kontrollit të ndotjes?	Jo.	Ska asnje arsye qe te kalohet kufiri normal i mbrojtjes se mjedisit.	Jo, ska efekte te tilla ne mjedis.
8.3	Nga ndonjë shkak tjetër?	Jo.	Ska shkaqe te tjera.	Jo.
8.4	Mund të ndikohet projekti nga fatkeqësi natyrore që shkaktojnë dëme për mjedisin (si përmbytje, tërmete, shkarje dheu, etj) ?	Jo.	Ska pasur lekundje sizmike apo shkaqe te ndryshme natyrore qe mund te vleresohen per ndikimin e tyre ne ndertim.	Jo.
9. A rezulton projekti në ndryshime sociale, p. sh. në demografi, mënyrë tradicionale jetese, punësim?				
9.1	Ndryshime në madhësinë e popullsisë, moshën, strukturën, grupet sociale etj.	Po.	Mund te coje ne rritjen e popullsisë si shkak i rritjese se nivelit jetik.	Rritja e nivelit jetik permireson nivelin e mbrojtjes per mjedisin.
9.2	Nga strehimi i njerëzve apo prishja e shtëpive, mjediseve të komunitetit si shkolla, spitale, mjedise sociale, etj.	Jo.	Ska prishje apo krijime strukturash te ndertuara me pare.	Ska ndikim ne mjedis persa u perket ketyre objekteve.
9.3	Nëpërmjet migrimit të banorëve të rinj ose krijimit të komuniteteve të reja?	Jo.	Komunitetet qe ekzistojne mund te zgjerohen dhe rriten por jo te migrojne.	Ska ndikime ne mjedis persa i perket migrimit pasi ky fenomen nuk ekziston.

**RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT
ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"**

9.4	Nga realizimi i kërkesave në rritje për mjedise e shërbime sociale si strehimi, arsimi, shëndeti?	Po.	Me rritjen e nivelit jetik dhe aktoret perberes rriten ne cilesi dhe sasi.	Ska ndikime negative ne mjedis.
9.5	Nga krijimi i vendeve të punës gjatë ndërtimit ose shfrytëzimit apo humbjes së vendeve të punës me pasoja në papunësi dhe ekonomi?	Po.	Ka efekt pozitiv persa i perket krijimit te vendeve te reja te punes.	Ska ndikim negativ nga ky punesim.
9.6	Ndonjë shkak tjetër?	Jo.	Ska shkaqe te tjera.	Jo.
10. A do çojë projekti në një presion për zhvillime të mëtejshme që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në mjedis, për shembull më shumë banesa, rrugë të reja, industri ose veprimtari të tjera mbështetëse, etj.?				
10.1	A do të çojë projekti në presione për zhvillime të mëtejshme që do të ketë ndikim të caktuar në mjedis si më shumë strehim, rrugë të reja, industri apo shërbime publike mbështetëse të reja	Po.	Mund te kete por ka banesa bosh ekzistuese.	Ska efekte negative persa i perket rritjes se popullates, industria nuk parashikohet te jete aktive ne kete zone.
10.2	A do të çojë projekti në zhvillimin e mjediseve mbështetëse, në zhvillime ndihmëse ose zhvillime të nxitura nga projekti që mund të ketë ndikim në mjedis, p.sh: 1. infrastrukturë mbështetëse (rrugë, furnizim me energji elektrike, trajtim i mbeturinave ose ujërave të përdorue, etj) 2. zhvillim i strehimit 3. industri nxjerrëse (ekstraktuese), 4. industri furnizuese, 5. tjetër?	Po	Do kete rritje te popullsise por jo te numrit te banesave. Industri nxjerrëse ska patur. Industri furnizuese ka por mund te perforcihen, keto mund te jete ekonomi private te vogla ne sasi sic eshte ajo e peshkimit dhe kultivimit te peshkut ne basen.	Ndikime negative ska ne lidhje me projektin qe do ndertohet. Autoritetet mjedisore rajonale vleresojne me tej cdo industri shtese ne kete zone.
10.3	A do të çojë projekti në një ripërdorim të kantierit mbas shfrytëzimit të tij që do të ketë	Jo.	Sdo kete perdorim te kantierit mbas ketij objekti, makinerite do	Ska efekte negative ne mjedis nga ky

**RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT
ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"**

	një ndikim në mjedis?		jene te kontraktuara.	proces.
10.4	A do të çojë projekti në krijimin e një precedenti për zhvillime të mëvonshme?	Jo.	Sdo kete asnje precedent te mundshem te parashikuar apo menduar qe mund te coje ne ndalimin e mevonshem te zones.	Ska efekte negative ne mjedis ne kete zone.
10.5	A do të ketë projekti pasoja kumulative për shkak të afërsisë me projekte të tjerë ekzistues ose të planifikuar e me pasoja të ngjashme?	Jo.	Ska projekte te tjera ne afersi dhe si rezultat ska as efekte kumulative.	Ska ndikime te kesaj natyre ne mjedis per kete zone.

- *Lloji i ndikimeve te identifikuarra (direkte dhe jo indirekte)*

Nga vleresmi i veçorive kryesore te projektit, dhe me investigimet ne zonen e parashikuar per ndertimin e HEC "BORIE-LURE 1" eshte bere identifikimi dhe vleresimi i ndikimeve te mundeshme ne mjedis. Ne perputhje me Udhezimin "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie" me keto identifikime dhe vleresime eshte plotesuar tabela I e Aneksit II te ketij udhezimi per te analizuar ne menyre te detajuar vleresimet sasiore te ndikimeve ne mjedis nga zbatimi i projektit te ndertimit te HEC "BORIE-LURE 1".

Shtirja hapesine e ndikimit negativ ne mjedis ka relativisht nje rreze te ulet nga vendi ku do te ndertohet hidrocentrali. Ndikimet kryesore ne hapesiren ku do te ndertohet ndahet ne dy siperfaqe, bazuar dhe ne llojin e ndikimit:

Hapesira ku do te ndertohet vepra, ndikimet negative.

Siperfaqja ku do te ndertohen veprat si vepra marrje, dekantues basen presioni, tubacioni i turbinave dhe godina e HEC-it. Perafesisht do te zihet ose priset nje siperfaqe prej $Stot=2290 \text{ m}^2$

- *Vepra e marrjes, dekantuesi, baseni i presionit, $S1=1000 \text{ m}^2$*
- *Tubacioni i turbinave $S2=790 \text{ m}^2$*
- *Godina e HEC-it $S3=500 \text{ m}^2$*

Ndikimi negativ ne kete siperfaqe do te jete kryesisht ne germime dherash per hapjen e themeleve te veprave. Rreth 80% qe do te dalin nga germimet do te rifuten ne pune pasi do te sherbejne si material mbushes per kanalet dhe pjeset anesore te mureve te


RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"

veprave, ndersa pjesa tjeter te do te hidhet brenda hapësirës ndertuese te vepren ne vende pa interes publik dhe ne gropa te cila kane nevoje per mbushje gje e cila do te konsultohet edhe me pushtetin lokal te zones. Prerje pemesh dhe zenie te siperfaqes se gjelbert nuk do te kemi pasi te gjitha veprat shtrihen ne shtrat te perroit dhe kjo zone karakterizohet nga zone zallishte pa hapësira te gjelberta.

Hapësira jashte siperfaqes ku do te ndertohet vepra, qe do kete ndikime negative.

Jashte siperfaqes se ndertimit te vepres ndikime negative do te kemi vetem ne zhurmat, ngritja e pluhurit dhe vibrimet te cilat i permendem dhe me siper per marrjen e masave te tyre. Ndikimi i tyre do te jete brenda normave te lejuar dhe oraret e punimeve do te zgjidhen ne menyre te tille qe te mos kete shqetesime per banoret e zones.

Zonat e banuar (fshatrat) nga vendertimi i vepres kane nje largesi rreth 360 m keshtu qe zhurmat, vibrimet dhe pluhuri do te jene ne masa te paperfillshme.



RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"

Faza e pare.

Pergatitjen e raportit te fizibilitetit, dhe marrjen e koncensionit per shfrytezimin e perrenjve te Kurores se Lures per HEC "BORIE-LURE 1" (shif projektin dhe harten).

Faza e dyte.

Ndertimi i vepres hidroenegjitike, shfrytezimin e tij dhe prodhimin e energjise elektrike. Bazuar ne kerkesen e vete subjektit, rezervave te shfrytezueshme, kapacitetit prodhues te HEC-it prodhimi vjetor ne objekt eshte **parashikuar E.totale= 6,296,831 wh/vit** Mbetjet e prodhimit do te depozitohen e rihidhen ne objekt per te frenuar gerryerjen e metejshme te shpatit.

Organizimi

Objekti do te jete nen administrimin e kompanise "AGETA "shpk dhe "BAJRAMI N" shpk . Ai do te kete ne perberje drejtues teknike e mekanike.

Ne HEC do te punohet me turne, dhe puna eshte teresisht e mekanizuar.

Kapaciteti prodhues eshte **E.totale= 6,296,831 wh/vit**

Masat për rigjenerimin e sipërfaqes gjatë dhe pas shfrytëzimit

1. Krijimi i sipërfaqes për mbjellje te reja e gjelberime.
2. Sistemimin e materialit të mbulesës dhe të sterileve që dalin gjate ndertimit.
3. Mbjelljen e sipërfaqeve të reja me fidane shelgu, plepi, akacie.
4. Mirëmbajtja e sipërfaqeve të mbjella.
5. Sistemimin e brigjeve anësore.
- 6.Mbjellje fidanesh të rinj.

Në vitin e parë dhe në çdo vit në vazhdim do të mbillen rreth 500 fidane plepi dhe shelgu.

Gropat do të hapen me përmasa 80 x 80 x 80 cm.

Hapje gropash	500 copë x 100 lekë/copë	50 000 lekë
Blerje fidanash, transport etj.	500 copë x 100 lekë/copë	50 000 lekë
Mbjellje, plehërim	500 copë x 50 lekë/copë	25 000 lekë
Totali i preventivit		125 000 lekë

Grumbullimi i dheut aktiv në sipërfaqe të vepres

Volumi i dheut qe do te levizet eshte 5999 m³

Transporti dhe sistemimi 5999m³ x 70 lekë/m³ = 419930 lekë

Sasia e dheut të kërkuar do merret nga grumbullimi i dherave të nxjera gjatë ndertimit.

Preventivi përmbledhës për rigjenerimin e mjedisit

Emërtimi	Vlefte në lekë
Mbjellje fidanesh të rinj	122 000
Grumbullimi i dheut aktiv	138 000
Totali i preventivit për një vit	260 000
Kosto për rigjenerim / 1Kwh prodhim	0. 056

1- Mbjelljen e sipërfaqeve te shfrytezuara të shkalleve me bime e peme.

2- Sistemimi i sterileve.

3- Mirembajtjen e sipërfaqeve te mbjella.

4- Sistemimin e skarpateve para e pas shfrytezimit.


Mbjellja e fidaneve te rinj

Duke qene se si pasoje e shfrytezimit do te krijohen gropa, kanale projekti parashikon qe te mbillen peme ne keto sipërfaqe te lira. Ne sipërfaqen qe duhet te rehabilitohet perfsihien 0.2 ha sipërfaqe e shesheve te depozitimit te mbetjeve dhe 0.63 ha sipërfaqe e kanaleve te tubacioneve te turbinave. Per kete subjekti parashikon te shpenzoje nga fitimet e saj. Procesi per sistemimin e taracave dhe mbjedhjen e pemeve do te filloje mbas fillimit te shfrytezimit ,dhe do te vazhdoje per 10 vjet deri ne fazen e shfrytezimit duke mbjelle cdo vit nga 500 renje peme. Keshtu gjithë sasia prej 5999 m³ qe zene nje sipërfaqe prej 0.2 ha do te te hidhen ne 5 pozicione ndryshme ne vende ku nuk ka peme, zonat zhveshura, gropa te shkatuara nga veprimet tektonike sic tregohen ne harten topografike bashkengjitur ketij relacioni. Perkujdesja e firmes per zhvillimin e bimesise do te vazhdoje edhe mbas mbjelljes.

Pas hedhjes se ketyre materialeve sipërfaqja e zene do te mbillet me bar, si terfili dhe troska, pa prishur dhe njetrajtshmerine natyrale te zones perreth.

Sa me siper duhet te theksojme qe sipërfaqet qe do te germohen per shkak te vendosjes se tubacioneve apo kanaleve jane zgjedhur ne menyre te tille per t'ju shmangur pyjeve dhe kullotave.

Veprat qe do ndertohen ne sipërfaqe ne zona te zhveshura, pa interes publik, toka shteterore me bimesi te rralle ku sipërfaqja e tyre shkon rreth 10661.6 m², nga keto



vetem 200 m² do te shkelen ne vende te gjelberuara me peme te cilat jane menduar te rimbillen serisht. Kjo siperfaqe prej 250m² qe do demtohet, eshte llogaritur se ne te do te mbillen rreth 100 fidane (si shelg,plep) etj.

Perfundimisht ne kemi thene qe do te mbjellim 500 fidane ne cdo vit per 10 vjet qe ne total i bie rreth 5000 fidane per te gjithë zonen e perkthyer kjo ne siperfaqe I bie rreth 2500 m², dhe kemi arritur ne kete perfundim, se keto fidane do te mbillen rreth godines te HEC-it, dhe veprave te tjera apo ne pjese te ndryshme te terrenit, ku mendohet se do kete rreshqitje te shpateve, per siguruar si vepren edhe rruget ekzistuese, por brenda ketij plani natyrisht qe futen dhe fidanet qe do prishen apo shkulen si rezultat i nevojës se punimeve qe kemi thene mesiper e perkthyer ne siperfaqe eshte rreth 200 m².

Pra, e thene perfundimisht jo e gjithë siperfaqja qe ne do te perdorim per ndertimin e vepres do te jete e mbjelle por nje pjese e saj ne ato raste kur nuk ka mundesi te tjera qe jemi te detyruar te prishim me patjter fidane, eshte menduar qe kjo siperfaqe relativisht e vogel rreth 200 m² .

Sistemimi i sterileve

Sistemimi i mbetjeve teknologjike sic theksohet me siper do te behet ne sheshin qe do te krijohet ne fazen e ndertimit dhe me pas kur te filloje sistemimi I skarpateve do te merret e do te depozitohet ne ane te shtratit te vepres per te realizuar krijimin e shtresave vegjetale e mbjelljen e pemeve per mbrojtjen nga erozioni I metejshem. Volumi I sterileve qe do te krijohen eshte 5999 m³ dhe do te sistemohet ne 6 pozicione te ndryshme.

Mirembajtja e siperfaqeve te mbjella

Ajo do te realizohet nga subjekti. Mund te ngrihen prita per te perforcuar mbrojtjen e pyjeve nga erozioni ne zonat rreth karieres. Gjithashtu do te kujdeset per mbareshtimin e pemeve qe do te mbillen nga shoqeria. Per kullimin e ujrave qe do te grumbullohen ne sheshin e depozitimit te sterileve do te hapet nje kanal per drenimin e ujrave jashte sheshit te depozitimit .

Sistemimi i skarpateve para e pas shfrytezimit

Subjekti ka per detyre dhe do te realizoje sistemimin e mirembajtjen e skarpateve te shkalleve i shkaktuar nga ndertimi i veprave si dhe nga hapja e traseve te rrugeve te reja te cilat do te sherbejne per transportin e materialeve dhe si rruge lidhese per veprat e HEC-it. Duke qene se pjesa me e madhe e rrugeve te hapura gjate ndertimit te HEC-it do te jene te perkohshme, pasi infrastruktura egzistuese mbulon nevojat per hyrjen ne vepra dhe levizjen ne to nuk eshte e nevojshme te merren masa inxhinierike specifike. Ato do te mbahen nen vezhgim gjate gjithë kohës se shfrytezimit e me pas saj deri ne mbareshtimin e pyllit. Skarpatet do te mbushen me material steril, do te perforcohen me trungje e do te hidhen dhera te mbuleses mbi to. Mbase te jete lidhur toka do te filloje mbjellja e pemeve.

Pastrimi dhe pergatitia e sheshit

Traseja neper te cilen do te ndertohen kanalet e marries dhe do te shtrihet linja e tubacioneve ka shume pak, ose aspak vegjetacion te ulet. Asnje dru nuk do te pritet qe eshte jashte trasese se ndertimit te kanaleve dhe shtrimit te tubacioneve te HEC "BORIE-LURE 1"

Te gjitha paisjet qe do te kerkohen te perdoren dhe sjellin zhurma me te medha duhet te kufizohen ne oret e funksionimit, sipas situates perreth. Ne ditet qe ato do te perdoren do te synohet te kete nje numer minimal te punonjesve ne trasene e kanaleve dhe te tubacioneve.

Konflikti me perdorimin aktual te tokes si toke bujqesore

Nuk do te merret toke me qira per trasene e kanaleve dhe te tubacioneve, meqenese punimet do te jene kryesisht pergjate shpateve te maleve dhe ne shtratin e perrenjve te Kurores se Lures.

Shqetesime te ndryshme pe mund ti shkaktohen komuniteteve lokale

Te gjitha lejet duhet te merren nga autoritetet e komunitetit dhe nese perkohesisht preken siperfaqe toke, ato pas perfundimt te punimeve duhet te kthehen ne gjendjen fillestare.

Vendosja e veprave hidroteknike dhe e godines se hidrocentralit.

Nderhyrjet ne toke, gjate hapjes se kanaleve dhe per shtrimin e tubacioneve te dergimit te ujit ne hidrocentral, pritet te sjellin shqetesime te ndryshme.

Gjeresia e trasese se kanalit te vepres qe do te hapet te jete minimale per te zvogluar demtimin e siperfaqes se tokes dhe te sasise se dherave te germuara.

Magazinimi dhe trajtimi i materialeve te rrezikshme

Duhet treguar kujdes per te evituar ndotjen e tokes dhe ujit nga pikimet dhe rrjedhjet e mundeshme te lubrifikanteve dhe solventeve qe do te perdoren gjate ndertimit te vepres. Nje plan emergjence duhet te pregatitet ne rast te rrjedhjeve te lubrifikanteve dhe solventeve.

Hedhja e mbeturinave te ngurta dhe te lenget

Problemet shqetesuese qe lidhen me ndotjen e mjedisit jane dhe mbetjet e ngurta qe do te gjenerohen gjate ndertimit te vepres hidroteknike. Keto mbetje do te duhet te hidhen ne vende te caktuara nga pushteti lokal.

Problemet shqetesuese ne lidhje me kontaminimin e ujit

Nuk do te lejohet hedhja e mbetjeve te ngurta apo te lengeta ne mjedis te hapur dhe ne vijat ujore.

h) Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis;

Qellimi i hartimit te raportit te vleresimit te ndikimit ne mjedis eshte marrja parasysh e faktoreve qe ndikojne ne mjedis gjate ndertimit te objektit dhe funksionimit te tij.

RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"

Ky raport eshte pjesa me e rendesishrne e dokumentacionit te kerkuar, ne zbatim te procedures se nevojshme gjate procesit te miratimit te lejes mjedisore. Raporti ka gjithashtu si qellim te jape nje veshtrim te pergjithshem mbi efektet ne mjedis, alternativat e mundeshme dhe masat zbutese te efekteve te padeshirueshme.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis (VMM) eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultonin nga nje projekt i propozuar, si gjate zbatimit ashtu dhe gjate funksionimit te tij. VNM-ja perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet:

- Marrjes ne konsiderate e ceshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.

- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.

- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimit cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.

- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt, etj.

Qellimi i ketij Raporti te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM), i pergatitur per rastin e ndertimit te Hidrocentralit "BORIE-LURE 1", eshte qe te identifikojte pasojat e mundeshme negative mjedisore qe mund te krijohen gjate ndertimit dhe shfrytezimit te ketij hidrocentrali.

Gjithashtu nje tjetër synim i ketij Raporti te VNM-se eshte te percaktoje e te rekomandoje masat tekniko-organizative per zbutjen e faktoreve negative qe ekzistojne, dhe te atyre qe krijohen gjate ndertimit dhe shfrytezimit te tyre.

VNM-ja e ketij projekti eshte hartuar per te integruar mbrotjen ambientale ne jeten e perditshme, qe te udheheqe ne ndryshimin e sjelljes se komunitetit, duke u bere ne kete menyre forca shtytese e permiresimit te vazhdueshem.

- *Mundesia e zbutjes se ndikimeve dhe argumentimet perkatese nese per ndikime te caktuara nuk mund te merren masa zbutese.*

NDIKIMET NË MJEDIS DHE MASAT ZBUTËSE GJATË NDERTIMIT

Ngjarjet gjatë fazës së ndërtimit	Faktorët ndikohen	që	Impakti	Prioriteti
Kërkime gjeologjike	Kafshët e egra		Zhurme	I ulët
Prerje e vegjetacioneve ekzistuese	Pyjet		Ndryshim i habitatit	I neglizhueshëm
Zgjerimi i rrugëve ekzistuese	Komuniteti		Krijim oportuniteti, ndryshim i	I neglizhueshëm

**RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT
ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"**

		habitatit	
Lëvizje e tokës	Gjeologjia e zonës	Stabiliteti shpateve	I ulët
Gërmime kanalesh	Hidro-gjeologjia e zonës	Ndryshimi rrjedhjes së ujit	I mesëm
Mbushje permanente me materiale të shpateve	Gjeologjia e zonës	Stabiliteti shpateve	I ulët
Realizimi i pritave provizore	Jeta e ujit, hidrogeologjia e zonës	Ndryshimi hidrografisë së lumit	I mesëm
Krijimi i akumulimeve të përkohshme të dherave	Gjeologjia e zonës	Stabiliteti shpateve	I ulët
Zhvendosja e përkohshme e personave, rrugëve, linjave elektrike	Komuniteti	Krijimi oportuniteti	I neglizhueshëm
Realizimi i rrugëve ndihmëse dhe kantjerit	Komuniteti, kafshët e egra	Ndikim vizual, shqetësim i kafshëve të egra	I ulët
Mbetjet e ngurta të lumit	Ekosistemi ujor	Ndryshimi habitatit	I ulët
Devijimi i lumit	Ekosistemi ujor	Ndryshimi habitatit	I lartë
Përdorimi i ekskavatoreve, kamionëve, makinave, personelin për	Komuniteti, kafshët e egra	Zhurmë	I ulët
Prezenca njerëzore në vend	Komuniteti, kafshët e egra	zhurmë	I ulët

**RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT
ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"**

gjatë punimeve			
----------------	--	--	--

NDIKIMET NË MJEDIS DHE MASAT ZBUTËSE GJATË SHFRYTËZIMIT

Ngjarjet fazës ndërtimit	gjatë së	Faktorët ndikohen	që	Impakti	Prioriteti
Prodhim energjisë rinovueshme	i së	Komuniteti		Reduktim i ndotjes së mjedisit	I lartë
Vepra e marrjes		Ekosistemi ujour		Modifikim habitatit	I lartë
Veprat permanente shtratin e lumit	në	Ekosistemi ujour		Modifikim habitatit	I larte
Tubacioni derivacionit	i	Ekosistemi ujour		Modifikim habitatit	I lartë
Tubacionet turbinave	e	Kafshët e egra		Ndikim vizual	I mesëm
Linjat e reja elektrike	reja	Komuniteti, kafshët e egra		Ndikim vizual	I ulët
Shkëmbinjtë thyer	e	Ekosistemi ujour, komuniteti		Modifikim habitatit Ndikim vizual	I ulët
Argjinaturat		Ekosistemi ujour, komuniteti		Modifikim habitatit Ndikim vizual	I ulët
Modifikimi i nivelit të prurjeve		Peshqit		Modifikim habitatit	I lartë
		Komuniteti		Modifikim habitatit	I mesëm

**RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT
ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"**

	Komuniteti	Modifikim i aktiviteteve rekreative	
Zhurmat nga pajisjet elektromekanike	Komuniteti	Ndryshim i kualitetit të jetesës	I ulët
Largimi i materialeve nga shtrati i lumit	Ekosistemi ujor, komuniteti	Përmirësimi i cilësisë së ujit	I lartë

Perdorimi tokes

Ndertimi i veprave hidroteknike te HEC "BORIE-LURE 1", nuk krijon shqetesim per komunitetin perreth, si gjate fazes se ndertimit ashtu dhe ne fazen e shfrytezimit.

Punimet e ndertimit do te vazhdojne per nje periudhe te vogel kohe dhe nuk do te krijohen demtime te tokes. Nuk ka mbetje demtuese ne siperfaqen ku do te vendosen pritat, ku do te hapen kanalet e tunelet dhe kanalet e sjelljes se ujit. Duhet te theksojme qe permasat e ketyre kanaleve jane te vegjel te cilet nuk duken nga larg dhe nga zonat e banuara, por vetem nga kalimtarët qe kalojne aty afer.

Përsa i përket ndërtimit të ndërtesës së HEC "BORIE-LURE 1" ajo do te vendoset ne nje tarrace me nje hapësire te nevojshme qe lejon terreni ne kete zone. Thellesia e germimit dhe planimetria e tyre per ndertesen e centralit do te percaktohen me saktësi pasi te porositen turbinat dhe pajisjet e tyre elektro-mekanike per te siguruar mbrojtjen nga kavitacioni te tyre. Kuota e shkarkimit eshte paracaktuar te jete **▼shk=1155 m.**

Duhet të theksojmë edhe njëhere se i gjithë kompleksi i ndërtimit të Hydrocentralit "BORIE-LURE 1" duke filluar nga veprat e marrjes, kanalit te sjelljes e tubacioneve te derivacionit, dekantuesi dhe ndërtesë e hydrocentralit pergjithesisht nuk vendosen dhe nuk prekin toka bujqesore, por vetëm në shpatet e perroit dhe lugines.

Ndikimi ne popullsi

Ndertimi i HEC "BORIE-LURE 1", ne kete zone nuk ka per te sjelle probleme per komunitetin e kesaj zone. Realizimi i ketij projekti, duke mos patur nevojë per krijimin e nje rezervuari, nuk do te shkaktoje ndryshime ne popullsi te saj, apo zhvendosje te saj per shkak te ketij aktiviteti.

Nderkohe duhet te theksojme qe ndertimi i HEC "BORIE-LURE 1", do te kete avantazhe te medha, jo vetem per biznesin, por dhe per turizmin e kesaj zone. Planet ne perspektive per shtrirjen qe do te kete zona ne nje te ardhme te afert, kjo e bazuar dhe ne studimin urbanistik zonal te miratuar, si dhe vete situata shume e veshtire energjetike

RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"

qe po kalon vendi yne e rajoni ne pergjithesi, flasin per domosdoshmerine e fillimit sa me shpejt te ketij projekti.

Nderkohe duhet theksuar dhe fakti qe ne kete aktivitet mendohen te punesohen nje numer i konsiderueshem punonjesish duke zbutur sadopak plagen e papunesise dhe ate te emigracionit.

Ndikimet ne peisazh

Kemi theksuar se karakteristike e HEC "BORIE-LURE 1", eshte ruajtja dhe mos ndryshimi i peisazhit dhe mjedisit turistik te saj, prandaj peisazhi nuk ka per te patur asnje demtim dhe nuk do te kete nevoje per rigjenerim per periudhen e ndertimit dhe shfrytezimit te ketij hidrocentrali.

Bimet e ujit

Ne zonen ku do te merret uji nuk ka bime uji, per vete morfologjine qe ka lumi, dhe per karakterin abraziv te tij ne zonen ku do merret uji po dhe ne zonen ku do te ndertohet ndertesa e HEC-it.

Nga ky aktivitet nuk do te kete demtime te tyre dhe rrjedhimisht, as masa mbrojtese.

Humbja dhe demtimi i tipareve gjologjike, paleontologjike, problemi i mjedisit gjeologjik

Ne pikepamje te struktures gjeologjike dhe pamjes se relievit, kjo zone nuk ka vecori tipike dalluese dhe nuk ka asnje aresye te vleresohet ose te merret parasysht gjate ketij aktiviteti. Kjo zone perben nje peisazh te zakonshem gjeologjiko-gjeomorfologjik, katakteristike e ketij rajoni

Ndikimet positive ne mjedisin e zones se projektit.

Nga prioritetet te ndikimeve ne mjedis te prezantuara me siper ne menyre te permbledhur jane paraqitur efektet pozitive te zbatimit te projektit te ndertimit te HEC "BORIE-LURE 1".

Efektet pozitive

- Ne fazen e ndertimit te vepres do te kete hapje te vendeve te reja te punes
- Ndertimi i hidrocentralit do te permiresoje kushtet e jeteses se banoreve te zones
- Ngritja e kantjerit te ndertimit te hidrocentralit do te shoqerohet me hapjen dhe zhvillimin e aktiviteteve sociale dhe ndihmese efekti kryesor pozitiv do te jete prodhimi i enegjise se rinovueshme dhe reduktiomi i ndotjes se mjedisit
- Me ndertimin e HEC "BORIE-LURE 1", do te kemi permiresim te treguesve cilesore dhe sasore te furnizimit me energji elektrike te zones dhe te vendit ne teresi
- Pritet te kete nje permiresim te sistemit te sherbimeve dhe potencialeve rekreative te zones vecanerisht te turizmit
- Largimi i mbetjeve te ngurta nga shtrati i lumit do te permiresoje cilesine e ujit

RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"

- Aktiviteti i ndertimit nuk do t'i shkaktoje ndotje tokes, pasi nuk ka dhe as do te kete shkarkime ne mjedis.
- Nuk do te kemi ndotje te ajrit, sepse gjate punimeve ndertuese do te merren masat perkatese zbutese, ndersa pas perfundimit te hidrocentralit zonat e ndertimit te veprave do te kthehet ne gjendjen normale.
- Zona do te mbetet me po ato funksione per te cilat eshte destinuar dhe nuk do te kete ndryshim te ketij destinacioni.

Masat zbutese.

ZBUTJA E NDIKIMEVE & MASAT TEKNIKE.

Masat zbutëse për uljen e efekteve negative, janë domosdoshmëri në kushtet aktuale të vënies në punë të veprës dhe që i klasifikojmë:

- Me karakter teknik
- Me karakter organizativ
- Kontrolli dhe monitorimi në kohë

PLANI I ZBUTJES PËR PËRDORIMIN E TOKËS

Ndërtimi i kësaj vepre hidroenergjitike nuk do të krijojë shqetësime për terrenet rreth e rrotull gjatë procesit të ndërtimit, pasi do të merren masat për objektin në ndërtim. Gjatë kohës së konstruktimit të objektit nuk do të krijohen dëmtime të tokës, pasi nuk krijohen mbetje dëmtuese që të shkarkohen në të, si në sipërfaqen në dispozicion ashtu edhe përreth.

Edhe në rast se ky aktivitet në një të ardhme për arsye të ndryshme ndërpritet, i gjithë sheshi është plotësisht i përdorshëm për çdo qëllim tjetër. Nxjerrja e mineralit në këtë vepër është aktiviteti kryesor, që mendohet se ka ndikimet më të mëdha jo vetëm nga pikëpamja e efekteve momentale, por edhe për jetëgjatësinë e saj.

Ky aktivitet kërkon një fokusim të gjerë për zbutjen e ndikimeve negative dhe rritjen e atyre pozitive, jo vetëm në fazat gjatë shfrytëzimit, por edhe më pas, në periudhën e rehabilitimit e pas saj.

PLANI I ZBUTJES PER ZHURMAT

Gjate ndertimit te Hydrocentralit "BORIE-LURE 1", do te kete angazhim te makinerive per punime germimi, transporti materialesh, etj.

Per te zbutur efektin e trafikut te ngarkuar dhe te zhurmave qe e shoqerojne ate, me qellim uljen e shqetesimeve per popullaten qe jeton perreth zones se ndertimit te hidrocentralit, si rruge te perkohshme do te perdoren ku te jete e mundur rruget dytesore. Nga projekti jane parashikuar ndertimi i rrugeve ndihmese.

**RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT
ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"**

Transportimi i materialeve te ndertimit ne rruget egzistuese do te programohet me kujdes per te shmangur cdo shqetesim ne trafikun lokal. Gjate nates, automjetet e ndertimit do te kerkohet qe te operojne me shpejtesi te ulta dhe do te ndalohet perdorimi i borive.

Aktiviteti	Parametrat e monitoruar	Kostot	Përgjegjësi
Matja e nivelit të zhurmave	<ul style="list-style-type: none"> • Të bëhet një vëzhgim i strukturës së burimeve të zhurmave. • Realizimi i një harte të nivelit të zhurmave për objektin në fjalë. • Prespektiva e kontigjenteve të popullatës që preken. • Dhënia e sygjërimeve për problemet që mund të hasen 	<ul style="list-style-type: none"> • Personat të cilët duhet të angazhohen në matje duhet të jenë në profesionet: Njëri fizikant dhe tjetri laborant. • Duhet të parashikohet kostua për automjetin bashkë me karburantin për 7 ditë shërbimi në dispozicion. • Faza e dytë: Zhvillimi i matjeve 	Kompania
Rezultatet e matjeve të hidhen në një raport nivel të zhurmave të matura	<ul style="list-style-type: none"> • Data, vendi, ora e matjes, përshkrimi i kushteve meteorologjike, shpejtësia dhe drejtimi i erës. • Koha e referimit, e observimit dhe e matjes. • Zinxhiri i matjeve totale, duke përcaktuar këtu instrumentin e përdorur, gradën e saktësisë relative, çertifikata e vërtetësisë së tarimit, lloji i destinacionit të objektit për të cilin bëhen matjet, modeli, tipi, dinamika, përgjigjja në frekuenca në rast të përdorimit të një sistemi regjistrues ose riprodhues. • Lista emërore e specialistëve 		Kompania

RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT
ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"

	që kanë qenë prezent në matje, si dhe identifikimi dhe firma e specialistëve që kanë bërë matjet.		
--	---	--	--

PLUHURI

Në këtë kompleks do të jetë prezent ekzistenca e pluhurit, sepse do të ketë operacione pune që do të shkaktojnë pluhura, sic janë zbankimet, transporti i materialeve të ndertimit. Ambientet e brendëshme dhe të jashtme të veprës do të lahen me ujë pas çdo procesi operacional.

f) Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë);

Shtrirja e projektit HEC "BORIE-LURE 1" do të realizohet brenda lugines së perrenjve të Kurores së Lures nga kuota ▼1641.07m deri në kuotën ▼1166.0m dhe është shumë larg zonave kufitare, pra shtrirja e tij prek vetëm zonen lokale ku dhe ndikimi në mjedis i tij nuk do të jetë me natyrë kombëtare apo ndërkufitare por do të jetë ndikim lokal të cilin po e parashtrijme me poshte:

Gjate të ndertimit të HEC "BORIE-LURE 1", dhe të projekteve perkatëse, do të ketë ndryshime pothuajse të paperfillëshme të topografisë lokale. Në projektet e tij janë parashtruar një rrathë ndërhyrjesh që, në kombinim me masat e tjera suplementare të sistemimit dhe trajtimit, parandalojnë erozionin e mundshëm.

Gjate ndertimit të kanaleve, dhe tubacioneve nuk pritet të ketë ndryshime në topografinë lokale.

- Ndikimet në përdorimin e tokës dhe të burimeve.

- Në cilësinë dhe sasinë e tokës.

Sipërfaqja që do të përdoret për kalimin e kanaleve dhe të tubacioneve të HEC "BORIE-LURE 1" është kryesisht shoqëruarë e shpatit të maleve të krahut të majtë si dhe përgjate shtratit të këtij burimi. Pra nuk kemi të bëjmë me tokë bujqësore. Ndertimi i këtyre veprave hidroteknike dhe i godinës së hidrocentralit në këto zone, nuk ndikon negativisht në cilësinë dhe sasinë e tokës.

Në zonen e ndertimit të veprave hidroteknike, hap pas hapi është parashtruar sistemimi i terrenit dhe si pasoje zhvillimi i bimesisë spontane të mëparshme të kësaj zone.

Në zonen e shfrytëzuar, për shtrimin e tubacionit apo hapjen e kanaleve të marrjes së ujit, nuk janë parashtruar masa lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e zonave arkeologjike apo historike, pasi nuk ka të tilla në të.

RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKT
ZBATIMIN HEC "BORIE-LURE 1"

g) Certifikatën dhe licencën përkatëse të QKL-së, të specialistit që ka hartuar raportin paraprak të VNM-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Tregutit dhe Sipërmartjes

LICENCË



LR-7574-03-2014

NUS/NIPT: K616170401

Subjekti: "TAJULANT" SHPK

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Rruga Ferid Xhajko, Pallati 60/4,
Shtetia 1, Ap. 3

Kodi: III Z A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 04/03/2014

Atari i vletshmerise: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Kufizime specifike

Licenca ushtronet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Nënkategoria

Vepimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin në mjedis

Detyrime specifike

Licenca ushtronet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi


Vepimtaritë specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Vendi i kryerjes se vepimtarise

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Specialiteti

Ministria e Energjitikës dhe Tregutit
Komiteti Kombëtar i Energjitikës dhe Tregutit
Nendshkrimi




REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
Sëktori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
Rruga "Dardësi" Nr. 27 Tiranë Tel: 04 2256 113 Fax: 04 2270 627 - www.moe.gov.al

Nr. 100/2013 Prot.

Tiranë, më 17.02.2013

Nr. identifikues 99

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011
Për një ndryshim në Vendimin Nr.1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të
Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për
pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe
auditimin mjedisor":

Zuj. DITIKA QATIPI

Certifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për
të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme
mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të
ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Fatmir MEDIU





REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 2256 113 Fax. 04 2270 627 - www.moe.gov.al

Nr. 107 Prot.

Tiranë, më 10 / 12 / 2013

Nr. identifikues 97

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011
Për një ndryshim në Vendimin Nr.1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të
Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për
pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe
auditimin mjedisor";

Znj. ERJONA QATIPI

Çertifikoheç për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për
të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme
mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të
ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Fatmir MEDIU



Aneks 1

- Grafiku paraprak i punimeve.
- Planvendosja e veprave mbi hartën topografike, rrugëve të reja të aksesit në fazën e ndërtimit.

Pergatitur nga :

"TAULANT" sh.p.k.

Eksperte mjedisi: QKL, LN-7574-03-2014

Ditika Qatipi

Erjona Qatipi

Bashkepunim me, "EBS" sh.p.k.

Ing. Hidroteknik Fahri MAHO

Ing. Hidroteknik Taulant QEJVANI

Ing. Mjedis, Trajtim Ujerash Nelisa Haxhi



Investitor:

"AGETA" sh.p.k dhe "BAJRAMI N" sh.p.k



Tiranë, 2016.